

Llogaria NYC

Përmbledhje

Llogaria e Shkollave të NYC-së (NYC Schools Account - NYCSA) është një aplikacion në internet që ju lejon të shikoni informacionin akademik dhe biografik të fëmijës tuaj nga çdo kompjuter, telefon apo tablet. Aplikacioni është i përkthyer në nëntë gjuhë të tjera përveç anglishtes. Jo vetëm që mund të ndiqni përparimin akademik të nxënësit tuaj, por gjithashtu mund të shikoni burime të tjera arsimore për të mbështetur nxënësin dhe familjen tuaj.

MyStudent

Ndiqu informacionin e nxënësit tuaj si:

- Pjesëmarrja (Frekuentimi)
- Notat & Fletët e Notave
- Vlerësimet (rezultatet e testimeve)
- Informacioni i Kontaktit për Emergjencë
- Transporti
- Individualized Education Program (IEP) (Programi i Arsimit të Individualizuar)
- Formulare digjitale, përfshirë Formularin e Pëlqimit për Testimin COVID-19

Universiteti për Prindër (Parent University)

Universiteti për Prindër ofron një katalog të centralizuar me kurse, ngjarje live dhe aktivitete për të ndihmuar në lidhjen me familjet dhe mbështetjen e nxënësve.

Portali për Raportimin e Rasteve të Bullizmit

Raportoni incidente ngacmimi të rasteve të bullizmit në shkollën e nxënësit tuaj përmes aplikacionit NYCSA.

Si të krijoni një Llogari të Shkollave të NYC-së?

Ka tre mënyra për të krijuar një llogari NYCSA. Mund të vizitoni shkollën e fëmijës tuaj personalisht për të marrë një fjalëkalim të përkohshëm, mund të kontaktoni shkollën dhe të verifikoni identitetin tuaj përmes videokonference për të marrë një fjalëkalim të përkohshëm, ose mund të përdorni Kod Krijimi Llogarie që vjen në letrën e dërguar në shtëpi me fëmijën tuaj.

Personalisht ose online

1. Caktimi një takim me shkollën e fëmijës tuaj.
2. Paraqitni një dokument identifikimi me fotografi (p.sh., pasaportë, leje drejtimi, IDNYC), adresën tuaj të emailit, dhe numrin 9-shifror të ID-së së nxënësit, i cili ndodhet në fletën e notave të tij/saj. Nëse bëhet përmes videokonference, shkolla do të verifikojë identitetin e prindit/kujdestarit ose të nxënësit të kualifikuar me zë ose pamje.
3. Kur të krijoni llogarinë në shkollë ose përmes videokonference, do të merrni një fletë me fjalëkalimin e përkohshëm, ose personalisht në dorë, ose me email.
4. Shkoni te <https://schoolsaccount.nyc> dhe futni adresën tuaj të emailit dhe fjalëkalimin e përkohshëm. Ju lutemi kini parasysh që fjalëkalimi i përkohshëm skadon pas 30 ditësh. Do t'ju kërkohet të krijoni një fjalëkalim të ri, të vendosni pyetjet e sigurisë së llogarisë, dhe të konfirmoni adresën tuaj të emailit.

Vetë-Regjistrimi (Self-Serve)

Do t'ju nevojitet Kodi i Krijimit të Llogarisë që është dërguar në shtëpi nëpërmjet fëmijës suaj në një letër. Ju gjithashtu mund ta kërkonti këtë letër nga shkolla e fëmijës tuaj. Do t'ju nevojitet ky kod dhe numri 9-shifror i ID-së së nxënësit për të krijuar një Llogari të Shkollave të NYC-së (NYC Schools Account), ose për të shtuar fëmijë të tjerë në një llogari ekzistuese.

1. Vizitoni <https://schoolsaccount.nyc> dhe zgjidhni linkun “Create Account” (Krijo Llogari) që ndodhet në faqen e hyrjes.
2. Futni emrin tuaj, adresën e emailit dhe numrin e telefonit celular për të filluar të merrni njoftime. Mund të krijoni një llogari bazë pa një kod krijimi llogarie, por për ta lidhur nxënësin tuaj me llogarinë, do t’ju nevojitet ky kod.
3. Pasi të keni futur informacionin e kontaktit, zgjidhni “Konfirmo Email-in” (Validate Email). Mbajeni këtë faqe të hapur.
4. Hapni email-in tuaj për të marrë numrin e konfirmimit. Futni numrin në faqen “Konfirmo Email-in”.
5. Vazhdoni për të krijuar fjalëkalimin tuaj.
6. Vazhdoni për të krijuar pyetjet e sigurisë së llogarisë tuaj.
7. Futni Kodin Unik të Krijimit të Llogarisë, i cili është i veçantë për ju dhe nxënësin tuaj.

Në çfarë informacioni do të kem qasje?

Çdo i rritur i lidhur me dosjen e fëmijës suaj caktohet me një nga këto role: Kujdestar (Custodial), Jo-kujdestar (Non-custodial) ose Përdorues Shtesë (Additional user). Këto role përcaktojnë sa informacion mund të shikojnë për fëmijën tuaj në seksionin MyStudent. Të gjitha rolet e përdoruesve kanë qasje në Universitetin për Prindër (Parent University) dhe në Portalin për Raportimin e Ngacmimeve (Bullying Portal).

- Si Kujdestar, mund të shikoni të gjithë informacionin që është në dispozicion në Llogarinë e Shkollave të NYC-së të fëmijës suaj. Gjithashtu, mund të ftoni të rritur të tjerë që të shikojnë informacionin e fëmijës tuaj. Mund të përditësoni informacionin e kontaktit të të rriturve për emergjencë që figurojnë në dosjen e nxënësit, në mënyrë që ata të kontaktohen drejtpërdrejt në rast emergjence.
- Si Jo-kujdestar, mund të shikoni shumicën e informacionit në Llogarinë e Shkollave të NYC-së të fëmijës suaj. Jo-kujdestarët mund të përditësojnë numrin tuaj të telefonit celular në aplikacion, për rastet e emergjencave.
- Si Përdorues Shtesë, mund të shikoni vetëm informacionin që prindi kujdestar vendos të ndajë me ju.

Ku mund të gjej ndihmë për Llogarinë e Shkollave të NYC-së (NYC Schools Account)?

Nëse keni nevojë për ndihmë ose keni pyetje mbi përdorimin e llogarisë suaj, kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj ose telefononi 311. Gjithashtu mund të mësoni më shumë duke vizituar faqen e *Llogarisë së Shkollave të NYC-së* në <https://www.schools.nyc.gov/nycsa>.

Si ta përditësoj informacionin e kontaktit për emergjencë të fëmijës tim?

Nëse jeni prind që jeton me fëmijën tuaj ose kujdestar kujdestar ligjor, mund të përditësoni numrat tuaj të telefonit të shtëpisë, celularit dhe të punës, si dhe adresën tuaj të emailit apo të të rriturve të tjerë të regjistruar në dosjen e fëmijës tuaj në Llogarinë e Shkollave të NYC-së, duke përdorur faqen Kontakti i Emergjencës (Emergency Contact). Ju gjithashtu keni mundësinë të përditësoni gjuhën tuaj të preferuar për komunikim me shkrim ose të folur. Gjithashtu mund të përditësoni informacionin shëndetësor të fëmijës tuaj për ta ndarë me shkollën. Kjo përfshin emrin dhe numrin e telefonit të mjekut të fëmijës, çdo diagnozë të njohur, alergji, kufizime që mund të ndikojnë në aktivitetin fizik, dhe statusin e sigurimit shëndetësor.

Nëse keni nevojë të përditësoni adresën e shtëpisë, të përditësoni informacionin mbi vëllezërit/motrat në dosjen e fëmijës, ose të përditësoni informacion mbi një urdhër mbrojtjeje, duhet të kontaktoni drejtpërdrejt shkollën për të bërë ndryshimin.

Si mund të gjej më shumë informacion mbi Portalin për Raportimin e Ngacmimeve (Bullying Portal)?

Nëse keni nevojë për ndihmë në përdorimin e Portalit për Raportimin e Ngacmimeve ose për burime shtesë që ndihmojnë në ndalimin e diskriminimit, vizitoni *Respect for All: Fostering Anti-Bullying Practices (Respekt për të Gjithë: Nxitja e Praktikave Kundër Ngacmimit)* faqen e internetit: <https://www.schools.nyc.gov/school-life/school-environment/respect-for-all>.